

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, si gjykatë kontestimore e shkallës së parë, përmes gjyqtarit Sabedin Mushica me sekretaren juridike Adelina Brestovci, e sipas padisë së paditësit E.M. nga Gjilani, Rruga ” ... ” numër ..., e ndaj të paditurës Komuna e Gjilanit, Drejtoria Komunale për Arsim, të cilën e përfaqëson me autorizim përfaqësuesi ligjor i saj A.M., nga Gjilani, baza e kontestit, kompensim i dy pagave mujore për përcjellje në pension, për shpërblim jubilar dhe regresin, vlera e objektit të kontestit 1,521.48Euro, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, me datë 21.02.2018 shpallë, ndërsa i përpiluar me datë 20.03.2018 këtë:

### AKTGJYKIM

REFUZOHET e pabazuar në ligj kërkesëpadia e paditësit E.M. nga Gjilani, me të cilën ka kërkuar që të OBLIGOHET e paditura Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan që paditësit në fjalë t’ia paguaj edhe atë: dy (2) paga mujore për shpërblim jubilar në shumën prej 700.74 €, dy (2) paga mujore për përcjellje në pension në shumë prej 700.74 € si dhe regresin në shumë prej 120.00 €, të gjitha këto në shumën e përgjithshme prej 1521.48 € (njëmijë e pesëqindë e njëzet e një euro e katërdhjetë e tet centë), në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

### A r s y e t i m

#### Rrjedha e çështjes

Paditësi, E.M. nga Gjilani, më datë 08.05.2014, ka ushtruar padi për kompensimin e pagave pas pensionimit, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan.

Pas pranimit të padisë, kjo gjykatë duke vepruar në pajtim me nenin 394 dhe 395 të LPK-së, palës së paditur ia ka dërguar padinë, në mënyrë që e njëjta të paraqesë përgjigje lidhur me pretendimet e saj, ku me datë 22.10.2015, e njëjta ka paraqitur përgjigje në padi me të cilën në tërësi e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit E.M. si të pabazuar dhe i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoi në tërësi si të pabazuar.

Gjykata me aktvendimin e datës 02.10.2016, e ka pezulluar procedurën për 180 ditë.

#### Pretendimet e palëve ndërgjyqjese

Paditësi në seancën përgatitore<sup>1</sup>, kryesore dhe fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet pranë padisë dhe kërkesëpadisë dhe i ka propozuar gjykatës që të njëjtën ta aprovoi në tërësi si të bazuar me kamatë ligjore që paguajnë bankat për depozitim mbi një vit, edhe atë brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

I autorizuari i të paditurës A.M., në seancën përgatitore, kryesore dhe fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjegjës në padi dhe i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoi në tërësi si të pabazuar.

#### Provat e administruara në shqyrtimin kryesor

<sup>1</sup> Duke pretenduar se e drejta e tij ka mbështetje ligjore në nenin 2, 3 4 36 dhe nenit 38 të Kontratës Kolektive.

Me çëllim të vlerësimit të drejtë dhe vërtetimit të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, në procedurën e provave, gjykata bëri administrimin e provave edhe atë: -Kërkesa e drejtuar DKA-së, me numër të protokollit 06150555, e dt.07.05.2014;-Përgjegja në Kërkesë nga ana e DKA-së, me numër 06150555, e dt.07.05.2014;-Aktvendimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës, me numër të protokollit 05-061-24780, i dt.03.03.2014; -Vendimi nga Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës, i dt.18.04.2014;-Vërtetimi i lëshuar nga SHF “ ... ”, me numër 716/2014, i dt.27.03.2014;- Libreza e Punës me numër 30915 (dy fletë);-Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Gjilan me numër E.nr.510/2011, i dt.15.09.2011;-Lista e Punëtorëve që kanë kaluar në pension 2006-2010;-Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjilan, me numër C.nr.304/09, i dt.11.10.2010;-Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjilan, me numër C.nr.55/2011, i dt.30.03.2012;-Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjilan, me numër C.nr.51/2011, i dt.23.10.2012;-Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjilan, me numër C.nr.116/2011, i dt.21.05.2012;-Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjilan, me numër C.nr.678/08, i dt.22.07.2010;- Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjilan, me numër C.nr.420/2011, i dt.12.06.2012;- Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjilan, me numër C.nr.50/2011, i dt.04.04.2012;- Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjilan, me numër C.nr.155/11, i dt.09.07.2012; -Vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikqyrës, me numër 64302 (91) 2012, i dt.20.04.2012;- Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Gjilan, me numër E.nr.1354/12, i dt.11.10.2012;- Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, me numër MLC.nr.4/2010, I DT.14.12.2011;-Aktvendimi i Gjykatës së Qarkut në Gjilan, me numër AC.nr.357/12/, i dt.27.11.2012;- Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjilan, me numër C.nr.787/11, i dt.24.09.2012;-Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, me numër E.nr.1672/12, i dt.27.08.2013;- Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjilan, me numër C.nr.276/11, i dt.27.06.2012; -Vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikqyrës i Kosovës, me numër A02 (294) 2012, i dt.12.10.2012;- Aktvendimi i Gjykatës së Qarkut në Gjilan, me numër AC.nr.297/12, i dt.08.11.2012;- Aktvendimi i Gjykatës së Qarkut në Gjilan, me numër AC.nr.303/12, i dt.08.11.2012;- Aktvendimi i Gjykatës së Qarkut në Gjilan, me numër AC.nr.295/12, i dt.27.11.2012;-Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, me numër CA.nr.4317/2012, i dt.16.07.2014;-Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, me numër C.nr.289/15, i dt.21.09.2017;-Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, me numër C.nr.43/17, i dt.12.05.2017.

#### Vlerësimet juridike dhe faktike të gjykatës

Nuk është fare kontestuese se paditësi E.M. fillimisht ka qenë në marrëdhënie pune në Shkollën Fillore “ ... ” në ..., Gjilan, me një përvojë në këtë shkollë që nga data 01.09.1972-17.10.1990, e pastaj në Shkollën Fillore “ ... ” në Gjilan, edhe atë prej 18.10.1990 e deri më 15.03.2014, kur edhe është pensionuar, e që vërtetohet me Kopjen e librezës së punës” me numër 30915, si dhe me vërtetimin me numër të protokollit 716/2014 i datës 27.03.2014, i lëshuar sekretari i kësaj shkolle.

Paditësit E.M. i është ndërprerë marrëdhënia e punës me datë 15.03.2014, me aktvendimin me numër të protokollit 05 nr.061-24780 të datës 03.03.2014, i lëshuar nga Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, për shkak të moshës së pensionimit.

Gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, sepse paditësi kërkesëpadinë e tij e bazon në Kontratën e Përgjithshme Kolektive të Kosovës që ka hyr në fuqi në Janar të vitit 2005 dhe është zgjidhur sipas urdhrit të ligjit në Janar të vitit 2008, ndërsa e njëjta kontratë nuk ka qenë në fuqi në kohën kur paditësi ka shkuar në pension me datë 10.03.2013, fakt që vërtetohet me aktvendimin me numër me numër të protokollit 05 nr.495/2013 të datës 04.06.2013, dhe nga këto arsye e njëjta kontratë nuk mund të krijoj të drejta për paditësin e as detyrime për të paditurën.

Sa i përket pretendimit të paditësit se e drejta e tij ka mbështetje ligjore, në nenet 2, 3, 4, 36 dhe 38 të Kontratës Kolektive, gjykata ka vlerësuar se një pretendim i tillë është i pabazuar edhe atë duke u bazuar në nenin 51 të Kontratës së Përgjithshme Kolektive, ku është paraparë se “ *Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive të cilat kanë implikime financiare fillojnë të zbatohen nga data 01.01.2015...*”, kurse në anën tjetër sipas aktvendimit me numër të protokollit 05 nr.495/2013 të datës 04.06.2013, shihet se paditësi Sh.S. ka dalur në pension me datë 14.06.2013, çka do të thotë se dispozitat ligjore edhe atë nenet 2, 3, 4, 36 dhe nenit 38 të Kontratës Kolektive, nuk mund të kenë fuqi retroactive.

Po ashtu, sa i përket provave të dorëzuara nga ana e paditësit me parashtresën e datës 14.12.2017, gjykata nuk i mure për bazë me arsyetimin se secili rast është i veçantë dhe gjykata ka vlerësuar se të njëjtat prova materiale edhe atë Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Gjilan me numër E.nr.510/2011, i dt.15.09.2011;-Lista e Punëtorëve që kanë kaluar në pension 2006-2010;-Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjilan, me numër C.nr.304/09, i dt.11.10.2010;-Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjilan, me numër C.nr.55/2011, i dt.30.03.2012;-Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjilan, me numër C.nr.51/2011, i dt.23.10.2012;-Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjilan, me numër C.nr.116/2011, i dt.21.05.2012;-Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjilan, me numër C.nr.678/08, i dt.22.07.2010;-Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjilan, me numër C.nr.420/2011, i dt.12.06.2012;- Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjilan, me numër C.nr.50/2011, i dt.04.04.2012;- Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjilan, me numër C.nr.155/11, i dt.09.07.2012;-Vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, me numër 64302 (91) 2012, i dt.20.04.2012;- Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Gjilan, me numër E.nr.1354/12, i dt.11.10.2012;- Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, me numër MLC.nr.4/2010, I DT.14.12.2011;-Aktvendimi i Gjykatës së Qarkut në Gjilan, me numër AC.nr.357/12/, i dt.27.11.2012;-Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjilan, me numër C.nr.787/11, i dt.24.09.2012;-Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, me numër E.nr.1672/12, i dt.27.08.2013;- Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjilan, me numër C.nr.276/11, i dt.27.06.2012;-Vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës, me numër A02 (294) 2012, i dt.12.10.2012;-Aktvendimi i Gjykatës së Qarkut në Gjilan, me numër AC.nr.297/12, i dt.08.11.2012;- Aktvendimi i Gjykatës së Qarkut në Gjilan, me numër AC.nr.303/12, i dt.08.11.2012;- Aktvendimi i Gjykatës së Qarkut në Gjilan, me numër AC.nr.295/12, i dt.27.11.2012;-Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, me numër CA.nr.4317/2012, i dt.16.07.2014;-Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, me numër C.nr.289/15, i dt.21.09.2017;-Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, me numër C.nr.43/17, i dt.12.05.2017, nuk kanë mundur ta ndryshojnë gjendjen faktike dhe qëndrimin e marrur të gjykatës dhe të njëjtat nuk janë potencuar në arsyetimin e këtij aktgjykimi me që është fjala për faktet i relevante.

Nga arsyet e cekura më lartë e bazuar në nenin 143 të LPK-ës u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN  
C.nr.275/2014, Me datë 20.03.2018

Gjyqtari,  
Sabedin Mushica

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas pranimit të të njëjtit, në Gjykatën së Apelit në Prishtinë, ndërsa ankesa dorëzohet nëpërmjet kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme.